



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT**

*Adresa:* Rr “Reshit Collaku” Nr. 6 / Pranë ILDKP, Tiranë  
*Tel:* 042 220 499 *Site:* [www.kkk.gov.al](http://www.kkk.gov.al) *E\_mail:* info@kkk.gov.al

**U D H Ë Z U E S**

**Për Raportin e Performancës**  
**së Organizatave Jofitimprurëse (OJF) në Shqipëri**

*Publikuar Qershor 2020*

## **Përmbledhja dhe qëllimi i Raportit të Performancës të OJF-së**

Në zbatim të nenit 22 (3) të Ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, organizatave jofitimprurëse në Shqipëri u kërkohet të përgatisin dhe publikojnë, së bashku me pasqyrat e tyre vjetore financiare, një raport performance. Ky raport do të përgatitet nga ato OJF, që në pasqyrat e tyre financiare, shuma e aktivit ose e të ardhurave tejkalon vlerën 30 milion lekë.

Qëllimi kryesor i raportit të performancës është të sigurojë që një organizatë jofitimprurëse të jetë publikisht e përgjegjshme ndaj palëve të interesuara në paraqitjen e performancës së saj. OJF-të do të kishin një përgjegjësi shumë më të madhe ndaj një grupi më të gjerë të palëve të interesuara sesa, për shembull, njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme. Rrjedhimisht, raporti i tyre i performancës është një dokument i rëndësishëm që përcakton se për çfarë është krijuar OJF, çfarë ka arritur dhe çfarë ndryshimi ka sjellë me fondet që ka në dispozicion të saj.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, duke marrë parasysh nevojat për informacion të përdoruesve kryesorë të raportit të performancës së OJF-së, ka përgatitur një udhëzues për strukturën dhe përmbajtjen e këtij raporti. OJF-të ndryshojnë nga njëra tjetra, por normalisht për secilën prej tyre, të interesuarit për informacion si përdorues të raportit të performancës janë: financuesit, donatorët, mbështetësit financiarë, ofruesit e shërbimeve dhe përdoruesit e shërbimeve, përfituesit e tjerë si dhe anëtarët e organizatës.

Raporti i Performancës të OJF-së duhet të sigurojë një përmbledhje të drejtë, të ekuilibruar dhe të kuptueshme të strukturës së saj, qëllimeve, objektivave, aktiviteteve, performancës financiare dhe pozicionit financiar. Raportimi i mirë shpjegon se për çfarë është krijuar organizata jofitimprurëse, si po shkon ecuria dhe çfarë arrihet si rezultat i punës së saj. Raporti i performancës duhet të ndihmojë përdoruesit e mundshëm që të marrin vendime në lidhje me OJF-në, të vlerësojnë progresin e OJF-së ndaj objektivave dhe të kuptojnë planet e saj në lidhje me qëllimet.

Raportimi i mirë siguron një kontekst brenda të cilit interpretohen pasqyrat financiare. Gjithashtu lidh aktivitetet dhe arritjet e raportuara me burimet e të ardhurave të përdorura për t'i financuar ato si dhe shpenzimet e bëra në ato aktivitete. Raporti i performancës dhe

pasqyrat financiare të marra së bashku duhet të japin një pamje të asaj që ka bërë një OJF (*produktet e aktivitetit të saj*) ose të asaj që ka arritur (*rezultatet e saj*), ose çfarë ndryshimi ka sjellë (*ndikimi i saj*).

## **Përgjegjësia për përgatitjen, miratimin dhe publikimin e raportit të performancës**

Përgjegjësia për përgatitjen e raportit të performancës i takon drejtit të OJF-së. Ndërsa përgjegjësia për miratimin e raportit i takon Bordit Mbikqyrës (ose një organi ekuivalent). Bordi në tërësi, ose një anëtar i emëruar i Bordit që vepron në emër të tij, duhet të miratojë tekstin përfundimtar të Raportit të Performancës duke e nënshkruar dhe datuar. Raporti i performancës publikohet sipas kërkesave të parashikuara në ligjin e kontabilitetit për publikimin dhe depozitimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera në faqen e tyre të internetit.

## **Përmbajtja e raportit të performancës së OJF-së**

Raport i Performancës që OJF-të kërkohet të përgatisin në mbështetje të Ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, mund të paraqitet i ndarë në kapitujt e mëposhtëm:

- objektivat dhe aktivitetet;
- arritjet dhe performanca;
- raportimi financiar;
- struktura, drejtimi dhe mbikqyrja
- të tjera me interes nga OJF për t’u paraqitur

**Objektivat dhe aktivitetet.** Raporti i performancës ofron informacione që synojnë të ndihmojnë përdoruesin të kuptojë se si OJF synon të përmbushë qëllimet, aktivitetet që ndërmerr dhe çfarë ka arritur. Sa është e mundur, informacioni numerik i dhënë në raportin e performancës për burimet e shpenzuara për aktivitete të veçanta duhet të jetë në përputhje me

informacionin e dhënë në pasqyrat financiare. Organizatat jofitimprurëse duhet të japin një përmbledhje të:

- Qëllimeve, dhe
- Aktiviteteve kryesore të ndërmarra në lidhje me ato qëllime.

**Arritjet dhe performanca.** Raporti i performancës duhet të përmbajë një përmbledhje të arritjeve kryesore të OJF-së për periudhën përkatëse të raportimit. Do të duhet të identifikojë ndryshimet që ka sjellë aktiviteti i OJF-së në jetën, kushtet dhe mjedisin e përfituesve të saj dhe, nëse është praktike, të shpjegojë ndonjë përfitim më të gjerë për shoqërinë në tërësi.

OJF-të inkurajohen të zhvillojnë dhe të përdorin raportimin e ndikimit në shoqëri (*ndikimi, pa dyshim që është shprehja përfundimtare e performancës së një organizate jo-fitimprurëse*), megjithëse pranohet se mund të ketë probleme të matjes që lidhen me këtë qasje në situata të shumta.

Është e rëndësishme që lexuesi i raportit të performancës të kuptojë gjithashtu natyrën dhe shkallën e rolit të luajtur nga *vullnetarët e papaguar (nëse ka)*. Ky kontribut nuk njihet në pasqyrat financiare. Raporti i Performancës duhet të përfshijë një përshkrim të rolit të luajtur nga vullnetarët e papaguar dhe të sigurojë një tregues të natyrës së kontributit të tyre në punën e OJF-së.

**Raportimi financiar.** Raporti i Performancës do të përmbajë një përmbledhje të pozicionit financiar të OJF-së në fund të periudhës së raportimit, burimet kryesore të financimit në periudhën raportuese dhe mënyrën se si këto burime të ardhurash janë përdorur nga organizata për të përmbushur qëllimin (et) e saj. Vlerësimi financiar mund plotësohet me tregues kryesorë jofinanciarë të performancës, të rëndësishëm për OJF-në.

Në datën e miratimit të raportit të performancës dhe pasqyrave financiare, është me interes për përdoruesit e informacionit që OJF të shprehet për vijimësinë e aktivitetit të organizatës.

*Fondet (grantet) e dhëna nga OJF-të janë një aspekt i rëndësishëm i punës së shumë prej tyre.* Nëse nuk paraqitet në shënimet e pasqyrave financiare, informacioni duhet të jepet në raportin e performancës për t'u dhënë përdoruesve të pasqyrave financiare një kuptim të qartë të

aktiviteteve ose projekteve që janë duke u financuar nga OJF-ja dhe nëse ndihma financiare u është dhënë direkt individëve ose është dhënë për të ndihmuar një tjetër organizatë, për të ndërmarrë kjo e fundit aktivitete ose projekte. Në rastin e granteve dhënë organizatave, informacioni për marrësit (et) e financimit duhet të sigurohet i plotë dhe i qartë në mënyrë që përdoruesit të vlerësojnë llojet dhe gamën e organizatave të mbështetura me fonde nga OJF-ja.

**Struktura, drejtimi dhe mbikqyrja.** Raporti i Performancës do të sigurojë informacion që lidhet me organizimin dhe drejtimin e organizatës, përfshirë mënyrën e mbikqyrjes.

Ky kapitull duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm për OJF-në, ekipin drejtues dhe Bordin Mbikqyrës të saj:

- emrin e organizatës jo-fitimprurëse;
- çdo emër tjetër që OJF-ja përdor ose ka përdorur në periudhën (at) e mëparshme raportuese;
- numri i regjistrimit të OJF-së në autoritetin në të cilin regjistrohet si një organizatë jofitimprurëse dhe NIPT-i;
- adresën e zyrës kryesore;
- Strukturën organizative të OJF-së dhe, aty ku është e nevojshme, ato të filialeve të saj;
- Mënyrën si OJF merr vendime, për shembull, cilat lloje të vendimeve merren nga ekipi drejtues dhe cilat i janë deleguar stafit;

Gjithashtu raporti i performancës mund të përfshijë edhe informacione si më poshtë:

- emrat e të gjithë atyre që ishin në ekipin drejtues në datën kur u përgatit raporti i performancës ose që shërbeu si drejtimi i OJF-së në periudhën raportuese;
- emrat e të gjithë atyre që ishin në Bordin e OJF-së në datën kur u miratua raporti i performancës ose që shërbeu si Bordi i tij në periudhën raportuese.
- nëse është e rëndësishme, jepet fakti që OJF është pjesë e një rrjeti më të gjerë (për shembull nëse është e lidhur me një grup ombrellë), dhe si, nëse ndodh, ndikon kjo përkatësi në politikat operative të miratuara nga OJF;

- marrëdhëniet midis OJF-së dhe palëve të lidhura. Paraqiten me hollësi marrëdhëniet me çdo OJF apo organizatë tjetër me të cilat OJF bashkëpunon në ndjekjen e objektivave të saj shoqërore;
- një përshkrim të politikës së diversitetit të aplikuar në lidhje me ekipin drejtues dhe Bordin e OJF-së me fokus në aspekte të tilla si, për shembull, mosha, gjinia, prejardhja, arsimimi, etj. Përveç përshkrimit të politikës së diversitetit paraqitjen objektivat e kësaj politike të diversitetit dhe rezultatet që ka dhënë në periudhën raportuese.

## ANEKS 1

	<b>RAPORTI I PERFORMANCËS</b> <b>Emri i organizatës</b> <b>Periudha raportuese</b>
	<b><i>Objektivat dhe aktivitetet</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ qëllimi/et e themelimit;</li><li>➤ aktivitetet kryesore të ndërmarra në lidhje me qëllimin/et;</li><li>➤ mënyra e punës direkte apo nëpërmjet OJF-ve më të vogla;</li></ul>
	<b><i>Arritjet dhe performanca</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ arritjet dhe planet për të ardhmen të shoqëruara sipas mundësisë me rezultatet e matshme;</li></ul>
	<b><i>Raportimi financiar</i></b> <p><i>Do fokusohet në disa nga treguesit që vënë në pah vlerën e organizatës dhe që organizata zgjedh të vërë në dukje (duke qenë se në Shënimet e PF i ka shpjeguar zërat e PF ), ku mund të përfshihen:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ arritjet në gjetjen e burimeve të financimit;</li><li>➤ mirëpërdorimi i burimeve direkte nga OJF-ja apo organizatat të cilave i ka akorduar fonde (<i>si shoqëri mëmë, p.sh</i>);</li></ul>
	<b><i>Struktura, drejtimi dhe raportimi</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ të dhëna identifikuese për OJF-në (selia, numri i regjistrimit, NIPT-i, etj);</li><li>➤ struktura organizative e OJF-së; ku sipas objektivave dhe politikave të donatorëve e përfituesve, mund të përmenden;<ul style="list-style-type: none"><li>- Bordi (emrat ose “CV” e tyre që i rrisin vlerën OJF-së)</li><li>- Ekipi drejtues dhe organizimi i drejtimit; (për aq sa e mendon se duhen bërë publike)</li><li>- Politika të tjera të drejtimit sipas zgjedhjes së OJF-së;</li></ul></li><li>➤ informacion nëse OJF vepron si pjesë e një grupi apo një rrjeti OJF-sh;</li><li>➤ marrëdhëniet e OJF-së me organizata të tjera;</li></ul>
	<b><i>Të tjera me interes nga OJF për t’u paraqitur</i></b>